



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më _____._____. 2023

PROCES -VERBAL - Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“RIKONSTRUKSION I PJESSHËM I KATIT TË DYTË TË PALLATIT TË KULTURËS,
QENDRA MULTIFUNKSIONALE PËR SHTRESAT NË NEVOJË”, BASHKIA DELVINË.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Punime për ndërtime të plota ose të pjesshme – 45200000-9
- Punime ndërtimi – 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **1.249.269 (një milionë e dyqindë e dyzetë e nëntë mijë e dyqindë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë, pa TVSH.**

- Burimi i financimit: Ky objekt financohet nga UNDP, bazuar në Marrëveshjen Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë së Delvinës njoftuar me shkresën Nr. 1353 Prot, datë 21.06.2023 lidhur me fondet për këtë projekt.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, të shoqëruar me listën e çmimeve sipas zërave të preventivit (Shtojca 2);

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1, (Shtojca 7).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e Operatorit Ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur në qoftë se Operatori Ekonomik arrinë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në

një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që Autoriteti Kontraktor po prokuron.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi bilancet vjetore, për vitet financiare përkatësisht 2021 dhe 2022, ku bilanci i secilit vit nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Bilanci do të shoqërohet me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur subjekti është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete/ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
2. Kontratë Sipërmarrje;

3. Situacionin përfundimtar të punimeve të kryera;
4. Aktin e kolaudimit të objektit;
5. Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve ose Certifikatën e marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve;
6. Faturën tatimore për situacionin përfundimtar të punimeve;

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë Sipërmarrje;
2. Situacionin përfundimtar të punimeve të kryera;
3. Aktin e kolaudimit të objektit (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
4. Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve ose Certifikatën e marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve;
5. Faturën tatimore për situacionin përfundimtar të punimeve;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh (BO), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe
- b) Miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim operatorësh. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 (në rastin e procedurave të thjeshtuara), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës limit të kontratës, për një objekt të vetëm, ose dyfishin e vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

- NP - 3(A) Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;
- NS - 1(A) Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS- 4(A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM Nr. 92 datë 19.02.2014. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punës, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kërkesa e disponimit të një licence të tillë të lëshuar nga ana e organeve kompetente është e lidhur ngushtë me tipologjinë e shërbimit të kërkuar në këtë objekt kontrate.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda kufirit: 0-20 milion lekë.
NS-1A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda kufirit: 0-20 milion lekë.

NS-4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda kufirit: 0-20 milion lekë.
-------	---	-----------------------------	---	-----------------------------------

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente; e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **ISO 45001-2018** mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente; e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së nënshkruar midis tyre).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën Korrik 2023 e në vazhdim, konkretisht:

➤ **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit sipas (Shtojcës 8). Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për pjesëtarin e stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, diplomë.

- **Shënim:** Për pikën 2.3.4 operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit duhet të paraqesin Formularin e Vetëdeklarimit sipas (Shtojcës Nr. 8).
- Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinier në objek është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i inxhinierëve 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit:

- 1- (një) Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në objektin që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore/rikonstruktues, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 (dhjetë) persona** për periudhën, (Korrik 2023 – e në vazhdim), e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Korrik 2023 – e në vazhdim).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e Autoriteti/Enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentim: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë autoriteti është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar: Teknik Ndërtimi (Hidroizolues tarrace) – 1(një), Hidraulik – 1(një), Murator – 1(një), Bojaxhi – 1(një), Elektriçist – 1(një), Pllakashtrues – 1(një), Suvaxhi – 1(një) të vërtetuar me diploma/kualifikime ekuivalente nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuar nga ISHTI ose institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2023 e në vazhdim.

- **Shënim:** Për pikën 2.3.6 operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit duhet të paraqesin Formularin e Vetëdeklarimit sipas (Shtojcës Nr. 8).

- Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve të specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Punëtorët e specializuar (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë punëtore të specializuar sipas pikës 6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Referuar VKM-së Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë vijon:

Nr	Emri/përshkrimi i mjetit	Njësia	Sasia	Statusi
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (mbi 8 ton)	copë	1	Në pronësi/qera
2.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3,5 ton	copë	1	Në pronësi/qera

Operatori Ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë vijon:

- Kokore pune, minimumi - 10 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme, minimumi - 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi - 2 copë.

- Betoniere dore, minimumi - 1 copë.
 - Gjenerator, minimumi – 1 copë.
 - Jelek pune, minimumi - 10 copë.
 - Matrapik/kompresor, minimumi - 1 copë.
 - Tabela sinjalizuese/paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi - 5 copë.
 - Armaturë (dërrasë kallëpi/armature), minimumi - 20 m².
 - Skela suvatimi, minimumi - 50 m²
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
 - b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
 - c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
 - d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qera të tij/tyre.
 - e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (e vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **Shënim:** Për pikën 2.3.7 operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit duhet të paraqesin Formularin e Vetëdeklarimit sipas (Shtojcës Nr. 8).

Shënim: Në zbatim të pikës 1 të nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritet publike ose pale të treta Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së, dhe në këto rregulla” si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose pale e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike, sjellim në vëmendje se:

- *Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.*
- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, do të kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE) që të dorëzoj dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentat e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Neni 39, pika 6, gërma “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialisti i fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore rikonstruktuese sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM-në Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM-në Nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objekteve, mundësive të manovrimit me mjete të rënda.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qerasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST-së) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në Dokumentat e Tenderit (DT)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim:

Te preventivi/preventivat Autoriteti Kontraktor kërkon që disa produkte/mallra të jenë "Vendi",,, "Cilësi i I-rë"...

Sjellim në vëmendjen e operatorëve ekonomik të interesuar për këtë procedurë prokurimi se në zërat e preventivit të ngarkuar në SPE në të cilin janë përdorur termat si "Vendi",,, "Cilësi i I-rë"... etj, të cilat mund ti referohen një marke prodhimi, burimi specifik, markë tregtare, patentë apo çdo lloji të tillë referimi theksojmë se operatorët ekonomik për efekt të hartimit të ofertës së tyre duhet ti referohen përcaktimeve të pikës 3 dhe 4, nenit 36 të LPP-së dhe jo emërimeve të vendosura në preventiv.

Referime të tilla si "Vendi",,, "Cilësi i I-rë"... etj, të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalente"

NJËSIA E PROKURIMIT

Olsi Rexho

Besar Kapllani

Anastasia Duka